



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



LEGALIZIM
NDËRTIMIN



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

UDHËZUES PËR APLIKIM PËR LEGALIZIM TË NDËRTIMIT PA LEJE

(KATEGORIA III E NDËRTIMIT PA LEJE)

Shtator 2023

LEGALIZO NDËRTIMIN PA LEJE

Procesi i legalizimit të ndërtimit pa leje, si dhe regjistrimi në Kadastër dhe në Regjistrin për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme (RDPP) kryhet në përputhje me [Ligjin nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje](#) dhe [Ligjin nr. 08/L-184 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje](#), i cili parasheh një procedurë të thjeshtë dhe taksa të ulëta.


Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është organi kompetent për pranimin dhe trajtimin e aplikimeve për legalizimin e ndërtimeve të Kategorisë III.

Ndërtimet e Kategorisë III përfshijnë të gjitha ndërtimet me rrezikshmëri të lartë dhe interes kombëtar.

Për llojet e ndërtimeve të Kategorisë III dhe për informata më të detajura shikoni Shtojcën 1, të [Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110](#).



DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMIT TUAJ (KATEGORIA III E NDËRTIMIT PA LEJE)



1. Dëshmi për ndërtimin
e kryer para datës 5
Shtator 2018

5. Projektin e
ndërtimit pa leje

2. Dëshmi për të drejtën pronësore
ose të drejtën e shfrytëzimit mbi
parcelën

3. Dëshmi për kyçje në
infrastrukturë sipas
llojit të ndërtimit, nëse
është e aplikueshme



4. Dokumentacionin e hartuesit të
projektit të ndërtimit pa leje



Për procedurat themelore të kërkesave të shëndetit dhe sigurisë dhe detajet tjera të rëndësishme për këtë kategori, shihni [Udhëzimin Administrativ Nr 07/2019 për Kërkesat themelore të shëndetit dhe sigurisë, procedurat dhe dokumentacioni për trajtimin e ndërtimeve pa leje për kategorinë III](#). Për më shumë detaje rreth dokumentacionit dhe procedurave të aplikimit, ju lutem drejtohuni tek Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim.

Adresa: ish pallati i mediave "Rilindja" kati 14, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
Kontakti: +383(0)38 200 32053 ose +383(0)38 200 32645